

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BURSA

MEDREG

LICENCIME

NË DATAT 27 DHE 28 DHJETOR, ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË, ERE, U MIRËPRIT NGA HOMOLOGËT E KOSOVËS, ZRRE/ERO. GJATË KËTYRE DY DITËVE, U ZHVILLUA NJË MBLEDHJE E PËRBASHKËT ME ZRRE KU PALËT PJESMARRËSE SHQYRTUAN, DISKUTUAN DHE MIRATUAN KUADRIN RREGULLATOR QË DO T'I SHËRBEJË OPERIMIT TË BURSËS SË ENERGJISË, ALPEX, SI DHE BASHKIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELETKRIKE.

KRYETARËT E RREGULLATORËVE TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS, Z. AHMETI DHE Z.FEJZULLAHU GJATË FJALËS SË TYRE FALENDERUAN PALËT PJESMARRËSE DHE THEKSUAN RËNDËSINË E KËTIJ PROCESI JO VETËM PËR SHQIPËRINË DHE KOSOVËN, POR DHE PËR RAJONIN. [NJOFTIMI I PLOTË](#)



NË DATËN 1 DHJETOR U ZHVILLUA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E 34 E SHOQATËS SË RREGULLATORËVE TË MËSDHEUT, MEDREG, NËN MIKPRITJEN E RREGULLATORIT EGJIPTIAN TË GAZIT GASREG. KJO ASAMBLE U HAP ME FJALËN E PRESIDENTIT TË MEDREG, Z. PETRIT AHMETI, GJATË SË CILËS AI I UROI MIRËSERADHJEN TË FTUARVE DHE MË PAS I LA FJALËN KRYETARIT TË GASREG DHE ZV PRESIDENT I MEDREG Z. KAREM MAHMOUD. ASAMBLËNË GJITHASHTU E PËRSHËNDETI DHE MINISTRI EGJIPTIAN I ENERGJISË.

GJATË KËSAJ ASAMBLEJE U ZGJODH GJITHASHTU PRESIDENTI I RI I MEDREG, Z. ABDELLATIF BARDACH, PRESIDENTI AKTUAL I ANRE, SËBASHKU ME NDRYSHIME TË TJERA NË BORDIN DREJTUES, NDËR TË CILAT KOMISIONERJA E ERE ZNJ.SADUSHI ËSHTË RIZGJEDHUR TË MBAJË POZICIONIN E ZV. KRYETARES SË GRUPIT TË PUNËS SË KONSUMATORËVE DHE SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË ERE, Z.ELTON RADHESHI, I ËSHTË BESUAR KRYESIMI NË BASHKËPUNIM ME SEKRETARIATIN TË TASK FORCËS SË BASHKËPUNIMIT ME PLATFORMAT E UFM. [NJOFTIMI I PLOTË](#)

Në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Balkan Energy Trade" shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "KESH" sha në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm në Triport, Gjiri i Vlorës.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SHKOLLA BALLKANIKE E ENERGJISË

AKTIVITETE

U themelua më 16 dhjetor 2022, në Milano, Shkolla Ballkanike e Energjisë (BES) me seli në ambientet e Rregullatorit Italian. BES do të promovojë harmonizimin e kornizave rregullatore në nivel rajonal, me synim mbështetjen e zhvillimit të Tregut të Energjisë në Ballkan dhe integrimin të këtij të fundit në atë Evropian. Pas iniciativës së ndërmarrë nga ARERA, autoritetet rregullatore të Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut janë anëtarë themelues. Autoritete të tjera rregullatore do të mund ti bashkëngjiten në muajt në vazhdim.

[Lexo më shumë.](#)

Në vigjilje të Krishtlindjeve Enti Rregullator i Energjisë, organizoi ditën me fëmijët në punë. Mes kurozitetit për ambientin, emrat e njohur nëpërmjet prinderve, që tashmë marrin një portret, lumturisë së të qenit bashkë e emocioneve të pashmangshme në të rritur, ERE filloi për herë të parë këtë traditë të bukur, që urojmë të përcjellë gjithë gëzimin e jetuar, përmes fotove.



Gjatë muajit dhjetor Bordi i ERE-s ka zhvilluar tetë mbledhje, të cilat kanë rezultuar në dyzet e nëntë vendimarrje, ndër to veçojmë licencimin e dy subjekteve në prodhimin e energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike me kapacitet 2MW secila, duke rritur fuqinë prodhuese vendase me 4MW energji të gjelbër dhe dy subjekte në tregtimin e energjisë elektrike si dhe vendime në të cilat janë reflektuar ndryshime të nevojshme si pasojë e bashkëpunimit të vazhduar me partnerët vendas, apo subjekte të licencuara, por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit.

Gjithashtu, pjesë e axhendës mujore kanë qënë dhe seancat dëgjimore që lidhen me trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Për tu azhornuar me informacion më të detajuar, shfletoni faqjen tonë zyrtare.